



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:170390

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05529167

KF.nr.298/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Doni Product” Sh.P.K. me numër unik identifikues 810197310 dhe seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, Sh.P.K. me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me paditën e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlerë kontesti e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të mbajtur me 28.03.2024, në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, e në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur B.G., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Refuzohet si e pabazuar, kërkesëpadia e paditësit “Doni Product” Sh.P.K. me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” Sh.P.K., me seli në Prishtinë.
- II. Mbetet në fuqi Aktvendimi nr.01.3.2.2/9921,10240,104040,10405,10760,11058,11059 i datës 28.06.2021, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 02.08.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit

nr.01.3.2.2/9921, 10240, 104040, 10405, 10760, 11058, 11059 të datës 28.06.2021, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale dhe për shkak të rritjes së paarsyeshme të çmimit të mallit. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi ankesa e ushtuar nga paditësi si dhe të anulohet vendimi i doganës 01.3.2.2/9921, 10240, 104040, 10405, 10760, 11058, 11059 i datës 28.06.2021, si i pabazuar, dhe të obligohet Dogana që mjetet monetare më shumë të paguara në emër të detyrimeve doganore t'iu kthehen ankuesit në xhirollogarinë bankare. Më tej, paditësi në padi ka theksuar se e paditura me rastin e shqyrtimit të ankesës nuk i ka analizuar dokumentet e bashkangjitura deklaratës doganore, faturat dhe pagesat bankare të cilat përputhen me vlerën e faturave përkatësisht të DUD-ve kontestues, duke theksuar se Zyra Doganore në mënyrë paushalle ka vlerësuar mallin e paraqitur për zhdoganim duke u bazuar në metodën e 6-të të vlerësimit d.m.th. në bazë të dhënave të disponueshme përkatësisht sipas nenit 35 të KDA-së. Përfaqësuesja e autorizuar e paditësit, edhe pse e ftuar në mënyrë të rregullt, që dëshmohej nga fletëkthesa se ftesa për seancë është pranuar nga e njëjta, nuk ka arsyetuar mos pjesëmarrjen në seancë, andaj Gjykata seancën e shqyrtimit kryesor e ka mbajtur konform nenit 41 të LKA-së, meqenëse e njëjta mungesën nuk e ka arsyetuar.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Shton se aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe pranë sqarimeve dhe elaborimeve si në arsyetimin e vendimit të nxjerrë nga dogana, duke theksuar se Dogana ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit është bazuar në metodën 6 të vlerësimit, të nenit 35 të KDA, gjithmonë duke pas parasysh që sektori i vlerës në vazhdimësi ka përcjellë ndryshimet e çmimit për mallin lëndor kontestues, andaj edhe në bazë të këtyre ndryshimeve përkatësisht karakteristikave të ngjashme të mallit kanë përcaktuar çmimin për mallin lëndor. Në këtë kuptim dogana nuk ka mundur të bëjë konstatim tjetër të gjendjes faktike nga gjendja dhe çmimi i përcaktuar nga zyra doganore. Tutje ka theksuar se në procedurën ankimore pala paditëse nuk ka prezantuar kontratën e shitblerjes të lidhur me eksportuesin e mallit me të cilin do të cekeshin çmimet e mallit, kushtet e dërgesës, kushtet e pagesës, pastaj nuk ka prezantuar transaksionet bankare si dhe deklaratat eksportuese të shtetit eksportues dhe në këtë kuptim vërehet se paditësi nuk ka

prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar nenin 33 të KDA-së. Më tej shton se, ndryshe dogana ka disponuar me të dhëna të tjera nga ato të deklaruar nga paditësi në procedurë dhe në bazë të këtyre të dhënave të disponueshme lidhur me vlerën e mallit dogana ka caktuar vlerën e cila konsiderohet vlera reale e mallit lëndor kontestues. Së fundi ka theksuar se për këtë mall sektori i vlerës çmimet e mallit i rifreskon në baza javore dhe se këtu paditësi ka deklaruar dukshëm vlera më të vogla se sa vlera reale e mallit kontestues të cilat çmime aplikohen njëjtë për të gjithë importuesi e pemëve dhe perimeve. Andaj edhe dogana ka nxjerrë vendimin me të cilin ka refuzuar kërkesën e paditësit në procedurën ankimore për DUD siç janë të cekur në aktvendim duke hedhur poshtë kërkesën për disa DUD-a të tjerë si jashtë afatit ligjor.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 28.03.2024, ka administruar provat si në vijim: Aktvendimi 01.3.2.2/9921, 10240, 10404, 10405, 10760, 11058, 11059 i dt.28.06.2021, DUD-in R-11492/05.05.2021, Faturë AAA2021000000218, Urdhëresë financiare, DUD-in R-11495/05.05.2021; Faturë nr. 368 dhe urdhëresë financiare, DUD-in R-11524/05.05.2021; Faturë nr.0312/2021 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-11813/07.05.2021; Faturë nr. AAA2021000000226 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-11914/08.05.2021, Faturë nr. AAA2021000000227 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-11494/08.05.2021, DUD-in R-17276/07.05.2021; Faturë nr. 0320/2021 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-17307/07.05.2021; Faturë 0319/2021 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-12086/10.05.2021; Faturë 0329/2021 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-12232/11.05.2021; Faturë 0332/2021 dhe urdhërese financiare DUD-in R-12026/10.05.2021; Faturë AAA2021000000231 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-12041/10.05.2021; Faturë 386 & 387 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-1269/15.05.2021; Faturë 0344/2021 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-12709/17.05.2021; Faturë 0349/2021 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-12711/17.05.2021; Faturë 0348/2021 dhe urdhërese financiare, DUD -in R-13007/19.05.2021; Faturë 0356/2021 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-13491/24.05.2021; Faturë 419 & 420 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-13402/22.05.2021; Faturë 0369/2021 dhe urdhërese financiare, DUD-i R-13290/21.05.2021; Faturë 0364/2021 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-13142/20.05.2021; Faturë 0362/2021 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-13246/21.05.2021; Faturë AAA2021000000259 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-14079/28.05.2021; Faturë 430&431 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-14276/31.05.2021, Faturë 876 dhe urdhërese financiare, DUD-in R-14342/31.05.2015 Faturë 435 & 436 dhe urdhërese financiare.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjet në padi, deklarimeve në seancë, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga deklaratimet në ankesë/padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se paditësi ka paraqitur DUD-at R-11492/05.05.2021; R-11495/05.05.2021; R-11524/05.05.2021; R-11813/07.05.2021; R-11494/08.05.2021; R-12086/10.05.2021; R-12232/11.05.2021; R-17307/07.05.2021; R-17276/07.05.2021 R-12639/15.05.2021; R-12709/17.05.2021; R-12041/10.05.2021; R-12026/10.05.2021; R-13491/24.05.2021; R-13402/22.05.2021; R-13007/19.05.2021; R-12711/17.05.2021; R-13290/21.05.2021; R-13142/20.05.2021; R-13246/21.05.2021; R-104079/28.05.2021; R-14276/31.05.2021, R-14342/31.05.2021; R-12086/10.05.2021; R-12026/10.05.2021; R-12041/10.05.2021, për zhdoganim në zyrën e brendshme doganore Ferizaj, të njëjtit janë ri-vlerësuar bazuar në metodën e 6-të. I pakënaqur me vendimin e të paditurës, paditësi me datë 04.06.2021, 08.06.2021, 10.06.2021, 15.06.2021, 18.06.2021, ka ushtruar kërkesë për rishqyrtimin e vendimeve e për të cilën Dogana e Kosovës me datë 28.06.2021, ka nxjerr Aktvendimin nr. nr.01.3.2.2/9921, 10240, 10404, 10405, 10760, 11058, 11059 të datës 28.06.2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë për DUD-at: R-11492/05.05.2021; R-11495/05.05.2021; R-11524/05.05.2021; R-11813/07.05.2021; R-11494/08.05.2021; R-12086/10.05.2021; R-12232/11.05.2021; R-17307/07.05.2021; R-17276/07.05.2021 R-12639/15.05.2021; R-12709/17.05.2021; R-12041/10.05.2021; R-12026/10.05.2021; R-13491/24.05.2021; R-13402/22.05.2021; R-13007/19.05.2021; R-12711/17.05.2021; R-13290/21.05.2021; R-13142/20.05.2021, R-13246/21.05.2021, R-104079/28.05.2021, R-14276/31.05.2021, R-14342/31.05.2021 të ZBD Ferizaj, ndërsa ka hedhur poshtë kërkesën e subjektit për rishqyrtimin e vendimit R-12086/10.05.2021, R-12026/10.05.2021, R-12041/10.05.2021 të ZBD Ferizaj, si të ushtruar jashtë afatit. Kundër këtij aktvendimi paditësi me padinë e datës, 02.08.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ në gjykatë.

Gjykata gjatë administrimit të provave ka nxjerr konstatimin se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës duke vepruar sipas ankesës së paditësit, e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë me seli në Ferizaj, këtu paditësit, për rishqyrtimin e

këtij vendimi, ndërsa edhe ka hedhur si të jashtë afatshme për DUD-at e lartcekur. Në aktvendimin e kontestuar e paditura ka arsyetuar se rivlerësimin e mallit e ka bërë pasi që në këtë rast kemi të bëjmë me mall dhe të dhëna të disponueshme me çmime më të larta se ai i paraqitur nga subjekti, andaj në kuptim të këtyre Dogana e Kosovës nuk ka mundur të bëjë konstatim tjetër të gjendjes faktike nga gjendja dhe çmimi i përcaktuar nga zyra e pranimit qendror.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi janë kundërthënëse dhe si të tilla nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Konform nenit 44 të LKA-së, Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, e gjithashtu duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ.

Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata vlerëson si të pabazuar pretendimin e paditësit për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të aplikimit të gabuara të dispozitave materiale, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale dhe për shkak të rritjes së paarsyeshme të çmimit të mallit, me arsyetimin se zyra e pranimit qendror e Doganës së Kosovës, ka aplikuar metodën e gjashtë të vlerësimit duke mos arritur të kontestoj asnjë nga dokumentet e cekura, të cilat dëshmojnë vlerën e transaksionit dhe se aplikimi i nenit 35 të KDA-së ka qenë i gabuara dhe joligjor, e i cili pretendim është në kundërshtim me pretendimin e të paditurës, se në rastin konkret subjekti në procedurë këtu paditësi nuk ka ofruar dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar vlerën e deklaruar, kjo pasi që nuk ka deklaruar transfer bankar, si dhe dokumentacionin tjetër mbështetës për ta provuar vlerën e transaksionit si të pakontestueshme, e të cilin arsyetim, Gjykata e pranon si të drejtë, konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të bërë nga Dogana e Kosovës, këtu e paditura.

Gjykata vlerëson se e paditura e ka arsyetuar mjaftueshëm kalimin nga njëra metodë e vlerësimit në tjetrën. Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është

dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor me të dhëna dhe referenca të sakta të faturave në urdhërpagesat ndërkombëtare.

Paditësi i ka prezentuar Gjykatës provat materiale si faturat e mallit, megjithatë i njëjti nuk ka arrit të dëshmoj vlerën reale të paguar për mallin lëndor, prandaj edhe Gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e aktvendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pamjaftueshme, pasi që fakti vendimtar për tu dëshmuar se është paguar vlera e deklaruar e mallit lëndor është transaksioni bankar apo çfarëdo pagese tjetër për mallin e importuar.

Gjykata, vlerësoi edhe pretendimin e paditësit se aktvendimi i kontestuar nuk e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, prandaj si i tillë kërkon që të anulohet, mirëpo i njëjti rezulton të jetë i pabazuar meqë përveç të theksuarit në padi pretendimin e tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale ashtu siç edhe përcaktohet me sipas nenit 7, par 1, dhe 3, i Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla,”*. Gjithashtu edhe me nenin 38 të LKA-së për përcaktuar se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtrij faktet, në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Rrjedhimisht, barra për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Konform nenit 46 par 1 të LKA-së, Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109.

Gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë konflikt administrativ është i pamjaftueshëm e kjo në mungesë të pagesës bankare ndërkombëtare për mallin për të konstatuar se vërtet paditësi ka paraqit vlerën reale të mallit lëndor, pavarësisht pretendimeve të paditësit në padi i cili thekson se i ka bashkangjitur të gjitha dokumentet e nevojshme.

Me nenin 33 par.1 të KDAK-së është përcaktuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë”*, përderisa nenin 34 par.1 të KDAK-së përcaktohet se *“Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nënparagrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nënparagrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij”*.

Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se e paditura ka vepruar në përputhje me ligjin kur ka rivlerësuar mallrat e importuara nga paditësi. Ajo ka ofruar një arsyetim të qartë për përdorimin e metodës së gjashtë, ashtu siç kërkohet nga legjislacioni i aplikueshëm, veçanërisht pasi paditësi ka dorëzuar dokumente të pa harmonizuara me kërkesat ligjore.

Nga të cekurat më lart, Gjykata konform me dispozitat ligjore të nenit 43 par, 1, dhe nenit 46, par. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.298/22, datë 28.03.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.